

## Njoftim per konsultim publik

**Bashkia Maliq, data 23.12.2021, ora 10.00, salla e Këshillit Bashkiak)**

**Titulli:** Mbledhja e rekomandimeve për fillimin e procedurës për shitjes e aksioneve të Klubit të Futbollit “Klubi i Futbollit Maliq sh.a”

**Propozuesi:** Projekt akti është propozuar nga Kryetari i Bashkisë, Z. Gëzim Topçiu

**Sqarime për projekt aktin:** Relacioni sqarues i projekt aktit përcakton arsyet e paraqitura nga propozuesi i projekt aktit të cilat në mënyre të përmbledhur janë:

- **Nevoja për konsultim me publikun për fillimin e procedurës së shitjes së aksioneve të Klubit të Futbollit “Klubi i Futbollit Maliq sh.a”, për arsye të ndjeshmërisë publike që parqet çështja.**

**Kalendari i konsultimit:** Konsultimi publik do te realizohet në **Maliq, data 23.12.2021, ora 10.00, salla e Keshillit Bashkiak.**

Banorët e bashkisë Maliq, grupet e interesit, përfaqësues të komunitetit të sportit, përfaqësues të biznesit, do të kenë mundësi të konsultojnë;

Projekt-Vendimin e këshillit bashkiak.

### **“PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHITJEN ME ANKAND TË AKSIONEVE TË “KLUBIT TË FUTBOLLIT MALIQ SH.A“ NË MASEN 100%”**

Projekt – Vendimin e gjeni në linkun mëposhtë:

[https://www.bashkiamaliq.gov.al/files/ugd/85c2ea\\_cc5ce9f54620441398d2b8cc0322531e.pdf](https://www.bashkiamaliq.gov.al/files/ugd/85c2ea_cc5ce9f54620441398d2b8cc0322531e.pdf)

#### **Pjesemarrës:**

- **Nga ana e Bashkise dhe e keshillit bashkiak:** Keyetari i Këshillit Bashkiak, Kryetari i Bashkisë, Kryetari i Komisionit të Ekonomisë dhe Finances të Këshillit te Bashkisë, Komisioni i Kulturës Rinisë dhe Sporteve, Koordinatori per Njoftimin dhe Konsultimin Publik, Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerzore.
- **Nga komuniteti:** Banorët e qytetit te Maliqit, banore dhe perfaqësues nga NJA, perfaqësues nga institucionet, perfaqësues nga biznesi, OJF, nga grupet e interesit, etj.

**-Forma e konsultimit:**Takim publik

1. Prezantimi i Projekt-Aktit
-------------------------------

<p>Qëllimi i konsultimit publik</p>	<p>2. Evidentimi i mendimeve dhe rekomandimeve të pjesëmarrësve</p>
<p>Përshkrimi i çështjes</p>	<p>Bashkia Maliq propozon dhënien e pelqimit për fillimin e procedurës së shitjeve të aksioneve të “Klubit të Futbollit Maliq sha”. Procedura do të zhvillohet në përputhje me aktet ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Lutemi gjeni në linkun më poshtë Relacionin Shpjegues.</p> <p><a href="https://www.bashkiamaliq.gov.al/files/ugd/85c2ea_cc5ce9f54620441398d2b8cc0322531e.pdf">https://www.bashkiamaliq.gov.al/files/ugd/85c2ea_cc5ce9f54620441398d2b8cc0322531e.pdf</a></p> <p>Meqenese kjo çështje ka ndjeshmeri për interesin publik, kerkojme te marrim mendimin dhe rekomandimet e qytetareve dhe grupeve te interesit.</p>
<p>Pyetjet që ngrenë Këshilli ndaj publikut</p>	<p>Këshilli i Bashkisë është i interesuar të marrë opinionin e komunitetit në lidhje me çështjet si vijon :</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. A mendoni se shitja e aksioneve do të rrisë performancën Klubit të Futbollit Maliq?</li> <li>2. A mendoni se Bashkia duhet të vijojë të zotërojë një pjesë të aksioneve?</li> <li>3. A mendoni se bashkia duhet t'i shesë të gjitha aksionet</li> <li>4. Tjetër</li> </ol>
<p>Shpjegim të procesit që do ndjekë dhe veprimet që do të ndërmerren Këshilli për të shqyrtuar rekomandimet nga publiku deri</p>	<p>Pas mbledhjes së rekomandimeve, Këshilli i Bashkisë do të ndjekë hapat si vijon:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Realizimin nga ana e Sekretariatit të Këshillit i një Përmbledhje të Rekomandimeve që përfshin të gjitha mendimet dhe propozimet që do të vijnë nga pjesëmarrësit në konsultimin publik.</li> <li>2. Dërgimi i kësaj Përmbledhje Rekomandimesh Kryetarit të Bashkisë, Komisionit të Ekonomisë dhe Financës, Komisionit të Kulturës Rinisë dhe Sporteve në bashkinë Maliq.</li> <li>3. Shqyrtimi nga ana e Komisionit të Ekonomisë dhe Financës, Komisionit të Kulturës Rinisë dhe Sporteve të cdo rekomandimi dhe të opinionit të Kryetarit</li> </ol>

në marrjen e vendimit	te bashkise. 4. Marrja e vendimit për rekomandimet e dhena dhe reflektimi i tyre ne Projekt aktin e ri.që do të përfshihen në projekt buxhetin afatmesëm dhe projekt buxhetin vjetor. Vendimi i bashkëngjitet dokumentit të projekt – aktit. 5. Diskutimi dhe miratimi i aktit në Mbledhjen e Këshillit; 6. <b>Informimi i komunitetit</b> , për marrjen në konsideratë të rekomandimeve 7. <b>Publikimi</b> i aktit në faqen e Këshillit të Bashkisë dhe në tabelat e informimit; 8. <b>Njoftimi</b> i administratës për aktin e miratuar; 9. <b>Monitorimi</b> i zbatimit të tij.
Ndryshimet kryesore dhe/ose alternativat mundshme	Opsionet e mundshme janë për t'u shqyrtuar nga ana e Këshillit tone : -Mbajtja nga ana e bashkise e nje perqindjeje te aksioneve -Shitja e te gjitha aksioneve
Kontaktet dhe afatet e degimit te komenteve, rekomandimeve, verejtjeve	Sugjerimet janë të mirëpritura deri më datë 23 dhjetor 2021, në adresen e emailit <a href="mailto:gertiangjiriti@yahoo.com">gertiangjiriti@yahoo.com</a>
Data e publikimit	13. 12. 2021